

2

NOTICE
LIEG
K. W. ...
...



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE VLORË

NOTER AMARDA B. SHANAJ
ADRESA 29 NENTORI, DERSH VISH
HEKALI, ZK.8533, NR.6/661
TEL: 694701595

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 3019


Nr. koleksioni: 1674

Fier më 02/09/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti notarial përbëhet nga 4 fletë



A2021062180185070146

TAKSA E PULLËS
PAGUA



A2021062180185070146

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË "ELEZAJ" SH.P.K)

Sot, më datë 02 / 11 / 2021 (dymije e njezet e nji), para meje Notere AMARDA B. SHANAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Fier, 29 NENTORI, DERVISH HEKALI, ZK.8533, NR.6/661, u paraqit personalisht:

SHITES: Kapllan Elezaj, atësia Selman, amësia Qyqë, shtetas Shqiptar, lindur në Bardhaj, Dibër dhe banues në Divjakë, me adresë Karavasta E Re; Nd. 020; H. 01; Ap. 01; Remas; Remas; 9004; Divjakë, lindur më 19/01/1952, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me ID nr. 034986971 dhe nr. personal F20119008I, përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e posaçme" me Nr. Rep 2975, Nr. kol 1658, hartuar nga noter Amarda. Shanaj, në datë 31/08/2021, nga përfaqësues Refit Çela, atësia Gani, shtetas shqiptar, lindur në Lushnje, Lushnjë dhe banues në Durrës, lindur më 22/07/1964, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga karta e identitetit me nr. personal G40722101L. dhe .

BLERES: Lulzim Sterkaj, atësia Mark, amësia Leze, shtetas Shqiptar, lindur në Koplík, Shkodër dhe banues në Malësi E Madhe, me adresë Dedaj; Nd. 010; Shkrel; Dedaj; 0000; Malësi E Madhe, lindur më 18/08/1973, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036197527 dhe nr. personal H30818031P,

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "Elezaj" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Nepermjet ekstraktit të QKB, të nxjerre nga faja zyrtare e QKR, verifikoj Gjendjen e Regjistrimit të Shoqërisë dhe konstatoj se Shoqëria "Elezaj" Sh.p.k është shoqëri aktive, nuk është në proces falimentimi, nuk është në ndjekje penale, nuk është në sekuëstror apo në formë të tjera kufizimit të zotesisë së saj juridike dhe për të vepruar dhe se Kapllan Elezaj është përfaqësuesi i vetëm ligjor i saj.

Palet e kesaj kontrate me deshire te lire dhe me vullnet te pavesuar kerkuan nga une noteria redaktimin e kontrates se shitjes te kuotave te kapitalit themeltare ne shoqerine "Elezaj" Sh.p.k me nr.NUIS K74714401K si me poshte vijon:

BAZA LIGJORE :

Neni, 705- 761 e vijues të Kodit Civil, Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar . Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Fq. 1



A2021062180185070146

NENI 1 - OBJEKTI:

1.1 Kjo kontrate ka per objekt shitje në masën prej 100% (njqind perqind), te kuotes që zotëron pala shitese në kapitalin themeltar në shoqërinë "Elezaj" Sh.p.k, ku pala shitese Kapllan Elezaj është zoterues i 1 (nje) kuote ne masen 100% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise dhe bëhet blerja e kuotave nga Lulzim Sterkaj në masën totale të kuotave që shiten, te barabarta ne total me 100% te kuotave te kapitalit zoterues nga pala shitese

2.1 Çmimi i shitjes së kuotës së kapitalit të shoqërisë që Blerësi i detyrohet Shitësit për blerjen e saj është në vlerë monetare 600.000 (gjashtëqind mijë) Leke.

2.2 Palët deklarojnë se nga ana e Blerësit është likuiduar vlera monetare e sipërcituar prej 600.000 (gjashtëqind mijë) Leke, e cila përbën vlerën e plotë të pjesës së kuotës së shitësit, për të cilën palët kanë rënë dakord

NENI 2 PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria Tregtare "Elezaj"sh.p.k., me seli ne Fier, Lushnje, Lagjja "Xhevdet Nepravishta"Rruga Kadri Roshi, Aparatmenti nr.24, zona kadastrale nr.8571, është regjistruar në Regjistrin Tregtar me numër unik identifikimi NUIS: K74714401K datë 14.11.2007.

Me vendimin nr.1 të datës 31.08.2021 (dymijë e njëzetë e një) të Asamblesë të përgjithëshme të ortakëve të shoqërisë, është vendosur miratimi i shitje të kuotave prej 100% që zotëron ortaku Kapllan Elezaj ne shoqërinë "Elezaj" Sh.p.k ndërsa bëhet blerja e tyre nga Lulzim Sterkaj në masën totale të kuotave që shiten.

Me shitjen e kuotave nga pala shitese, ky veprim sjell humbjen e së drejtës së pronësisë të ortakut te vetëm Kapllan Elezaj në masën respektive 100 % të kuotave që zotëron në kapitalin themeltar të Shoqërisë "Elezaj" Sh.p.k

Shitësi është plotësisht dakord t'i shesë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, të gjitha kuotat prej 100%, që zotëron në kapitalin themeltar në shoqërinë te "Elezaj" Sh.p.k blesit të kuotave dhe përkatësisht Lulzim Sterkaj

Nga ana e tij blerësi i kuotave Lulzim Sterkaj është plotësisht dakord për shitjen e bërë nga ortaku i vetëm i shoqërisë "Elezaj" Sh.p.k, zoti Kapllan Elezaj (këtu i përfaqësuar me prokure) në masën 100 % të kuotave te tij.

Duke përfutuar pronësinë e kuotave të shitur në masën prej 100% te kuotave te shoqerise, bleresi i tyre Lulzim Sterkaj fiton cilësinë e ortakut te vetem ne shoqërisë "Elezaj" Sh.p.k me të gjitha të drejtat e detyrimet që sjell blerja e kuotave.

NENI 3 - MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

3.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitje zoti Kapllan Elezaj , humbet pronësinë mbi kuotat ne masën prej 100% që zotëron në kapitalin themeltar të shoqërisë "Elezaj" Sh.p.k duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi kuotat e shitur. Pala shitese deklaroi se nuk ka patur dhe nuk do të ketë asnjë pretendim për ndonjë të drejtë apo detyrim që rrjedh si rezultat i shitjes se 100% të kuotave që zotëron në shoqërinë "Elezaj" Sh.p.k

3.2 Pala blerese, Lulzim Sterkaj bëhet pronar në masën 100% të kuotave të blera me të gjitha të drejta dhe detyrimet që mbart pronësia e kuotave, duke fituar njëkohësisht dhe cilësinë e ortakut te vetem ne masen 100% te kuotave ne shoqerine "Elezaj" Sh.p.k

3.3 Pas realizimit të kësaj kontrate shitje, kuotat e shoqërisë shoqërisë "Elezaj" Sh.p.k do të zotërohen në këtë mënyrë dhe vetem nga: Lulzim Sterkaj



A2021062180185070146

3.4 Sipas këtij përcaktimi Blerësi, zoti **Lulzim Sterkaj**, paguan në favor të shitëseve të Kapllan Eezaj, i perfaqësuar me prokure nga Refit Çela shumën totale prej 600.000 (gjashtëqind mijë) lek, shumë e cila do të paguhet jashtë kësaj zyre noteriale.

3.5 Çmimi i parashikuar në këtë kontratë do të paguhet nga Blerësi në favor të shitëseve me një kest, në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

3.6 Palët në këtë kontratë kanë rënë dakort që pronësia e kuotave të kalojë në favor të blerësit me nënshkrimin e kësaj kontrate.

NENI 4 - MODALITETE E SHITJES

4.1. Palet, me vullnetin e tyre të lire dhe të plote, bien dakort që të gjitha detyrimet ndaj të treta që ka shoqëria "Elezaj" Sh.p.k nga krijimi i saj e deri në momentin e kalimit të pronësive nga pala Shitëse tek pala pranuese blerëse, janë përgjegjësi e pales blerëse dhe pala shitëse nuk ka asnjë detyrim ndaj të treta apo ndaj pales blerëse në lidhje me to.

4.2 Me nënshkrimin, pronësia mbi të gjithë Kuotat e pales shitëse dhe të drejtat e tjera që lidhen me to dhe ose rrjedhin prej tyre, përfshirë të drejtën e votes dhe të dividetit si dhe të drejtat në administrimin e Shoqërisë i kalon pales blerëse dhe pala shitëse zhvishet teresisht prej tyre.

NENI 5- DEKLARIME DHE GARANCI

5.1 Pala shitëse deklaron dhe garanton se ka të drejtë dhe nuk ka asnjë pengesë të çfaredo natyre që të lidhe dhe zbatojë këtë Kontratë dhe se kjo Kontratë përben detyrim ligjor, të vlefshëm, të detyrueshëm për palën shitëse. Kuota e pales shitëse, objekt i kësaj Kontrate sipas parashikimeve me sipër, shiten në gjendjen në të cilën është dhe me të drejtat që lidhen me të dhe/ose rrjedhin prej saj.

5.2 Pala blerëse, deklaron dhe garanton se ka të drejtë dhe nuk ka asnjë pengesë të çfaredo natyre që të lidhe dhe zbatojë këtë Kontratë dhe se kjo Kontratë përben detyrim ligjor, të vlefshëm, të detyrueshëm për palën blerëse.. Gjithashtu, pala blerëse blen Kuotën e pales shitëse objekt i kësaj Kontrate në gjendjen të cilën është dhe nuk ka asnjë pretendim në lidhje me të apo të drejtat që lidhen me të dhe/ose rrjedhin prej saj.

NENI 6- TË NDRYSHME

6.1 Secila prej Paleve do të perballojë shpenzimet e veta në lidhje me negociimin, nënshkrimin dhe përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë.

6.2 Kjo Kontratë përgatitet dhe nënshkruhet në kate origjinale me vlerë të njëjtte secili dhe ky akt përben të gjithë marrëveshjen e arritur midis Paleve, premtimet, deklaratimet, garancitë në lidhje me objektin e kësaj Kontrate. Asnjë ndryshim i kësaj Kontrate nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk bëhet me shkrim dhe nënshkruhet personalisht nga Palet e kësaj Kontrate apo perfaqësues të autorizuar rregullisht prej seciles nga Palet në fjale.

NENI 7- ANEKSET E KONTRATËS

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneks të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve me nr. 1, datë 31.08.2021, Prokure e poscme nr. 2975 rep, nr. 1658 kol Notere Amarda Shanaj; Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "Elezaj" Sh.p.k.. datë 31.08.2021, nxjerre nga sistemi elektronik e-albania; Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë; Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

100

100

100

100

100



A2021062180185070146

NENI 8- DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

13.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.


PALËT KONTRAKTUESE

SHITES

Kapllan Elezaj

i perfaqesuar nga Refit Çela

Refit Çela



BLERES

Lulzim Sterkaj

Lulzim Sterkaj

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
AMARDA B. SHANAJ

Amarda B. Shanaj

Amarda B. Shanaj

